



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronjat g), k) m) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 2 paragrafi 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neneve, 14 dhe 19 paragrafët 1.7 dhe 1.13 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe Rregullores nr.prot.01/172-400 për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të datës 27 shtator 2012, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në kuadër të masave për parandalimin dhe luftimin e Corona virusit COVID-19 si formë e mbështetjes për qytetarët dhe subjektet afariste në territorin e Komunës së Podujevës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 02 prill 2020, miratoi këtë;

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Ndahen mjete financiare në shumë 125,000.00 €, ndihmë qytetarëve në nevojë, me pako ushqimore dhe hixhienike, në territorin e Komunës së Podujevës, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Corona Virus COVID-19.

Neni 2

1. Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij Vendimi, ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe tranfereve, dhe atë nga:

- Drejtoria e Bujqësisë Pylttarisë dhe Zhvillimit Rural, shuma..... 80,000.00€
- Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, shuma..... 20,000.00€
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,..... 15,000.00€
- Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit,..... 10,000.00€

2. Mjetet e ndara sipas këtij neni, do t'iu kompensohen Drejtorive përkatëse, nga të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin 2019, të cilat do të barten në vitin 2020.

3. Implementimi i këtij Vendimi bëhet sipas procedurave të prokurimit publik.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bëjnë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-016/01-0020192/20
Podujevë,
02 prill 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi